



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

I. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Specialist i Sektorit të Lead dhe After Care / **Klasa:** IV-1

Sektori: Sektori Lead dhe After Care

Drejtoria: Drejtoria e IHD, Partneritetit dhe Kërkimit

Raporton te: Përgjegjësi i Sektorit të Lead dhe After Care

Qëllimi i Përgjithshëm i Pozicionit: Specialisti i Sektorit të Lead dhe After Care përgjigjet te Përgjegjësi i Sektorit të Lead dhe After Care dhe te Drejtori i Drejtorisë së IHD, Partneritetit dhe Kërkimit. Roli i tij fokusohet në tërheqjen e investitorëve të mundshëm dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për investitorët pas investimit.

Detyra kryesore që lidhen me këtë rol

- Mbledh dhe përpunon informacion, në kuadër të identifikimit/targetimit të investitorëve të synuar në sektorët strategjikë, si dhe asiston në përcaktimin e grupeve të targetuara;
- Kontribuon në krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të dhënash të kompanive të targetuara/asistuara/prezente ndërkombëtare me të dhënat e nevojshme të profilin të kompanisë;
- Vendos komunikime me grupet e targetuara, për t'i inkurajuar ato për të investuar në Shqipëri;
- Vendos dhe mban komunikime me të gjithë aktorët kryesor si, ambasadat, dhomat bilaterale të tretisë, komunitetin e diasporës, organizata të ndryshme me fokus në investime dhe agjenci simotra në rajon dhe botë;
- Kontribuon në drejtim të zhvillimit të fushatave promociionale, B2B, misione tregtare, panaiere ndërkombëtare për targetimin e investimeve, me qëllim promovimin e avantazheve që ofron Shqipëria për investitorët potencialë, krahasuar këto me vendet e rajonit;
- Kontribuon në realizimin e publikimeve dhe kërkimeve për sektorët prioritarë;
- Kontribuon në identifikimin e investitorëve të huaj sipas sektorëve strategjik të vendit;
- Kontribuon në hartimin e strategjisë për përkujdesjen e investitorëve të huaj në vend, identifikimin e problematikave të mundshme dhe adresimin e tyre të institucionet kompetente për zgjidhjen e tyre;
- Harton iniciativa me interes për investitorët e huaj dhe ata ekzistues;
- Identifikon evente apo ngjarje të rëndësishme që lidhen direkt me fokusin e drejtorisë;
- Drafton MOU dhe ndjek nënshkrimin e tyre me palët apo institucionet e interesuara;
- Mban kontakte me institucionet kryesore të cilët furnizojnë me të dhëna sipas fokus të drejtorisë, konkretisht, INSTAT, QKB, Drejtoria e Tatimeve dhe Doganave, si dhe BSH;
- Ofron udhëzime dhe mbështetje për investitorët e huaj për kërkesat rregullatore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe konsiderata të tjera ligjore që lidhen me investimet.
- Kontribuon në drejtim të përditësimit në mënyrë të vazhdueshme të materialeve promovuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Kërkesat e Posaçme:

Arsimi: Bachelor në shkenca shoqërore, juridike, marrëdhënie ndërkombëtare, ekonomike. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë paktën 2 (dy) vite eksperiencë pune në sektor që lidhen me misionin e drejtorisë.

Tjetër: Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre. Të ketë njohuri të gjuhës angleze; njohja edhe e gjuhëve të tjera përbën avantazh.